



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.98/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Qerim Ademaj dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.T.SH “[M...]” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati “[A.Q]” nga Prishtina, kundër të paditurës “[B...]” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokatja “[S.S]” nga Prishtina, për shkak të vërtetimit të ekzistimit të pronësisë mbi aksione, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.448/17 e datës 22/02/2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **13/07/2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHEN si të themelta ankesat e të paditurës N.T.SH “[M...]” me seli në Prishtinë dhe **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.448/17 e datës 22/02/2018 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor EK.nr.448/17 e datës 22/02/2018, ka vendosur si vijon: I. Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses N.T.SH “[M...]” me seli në Prishtinë, lidhur me vërtetimin e ekzistimit të pronësisë në aksione për palën paditëses N.T.SH “[M...]” me seli në Prishtinë me nr. të biznesit me seli në biznesit me seli në Prishtinë prej 720 aksioneve, vlera nominale e secilit aksion është 500,00 euro, ndërsa vlera e përgjithshme e të gjitha aksioneve është shuma prej 360,000.00 euro. II. Si dhe pretendimi i palës paditëse lidhur me detyrimin që Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi që ti evidentoj në emër të paditëses tek e paditura procesin e këtyre aksioneve. III. Detyrohet e paditura që t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shume prej 422.00 euro në emër të

palës se paditur ne afat kohore prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditëses.

E paditura ka dhënë përgjigje në ankesë, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e të paditurës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërteton.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe nenin 195 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja N.T.SH “[M...]” me seli në Prishtinë dhe “[M.B]”, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 30/10/2013, ka paraqitur padi, kundër të paditurës “[B...]” me seli në Prishtinë, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar ndërsa me parashtresën e datës 14/01/2015 e ka bërë ndryshimin e padis në kuptimin subjektiv, ashtu që në cilësinë e palës paditëse ka mbetur vetëm një paditëse dhe atë N.T.SH “[M...]” me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke arsyetuar se paditësja “[M.B]” me autorizimin e datës 13/06/2007 e ka autorizuar “[A.G]”, që në emër të firmës ti ndërmerret të gjitha veprimet si aksionar i “[B...]”, me të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat janë të parapara me aktet e Bankës dhe me ligjin në fuqi në Kosovë, po ashtu në aktgjykimin e atakuar është theksuar se paditësja “[M.B]” me kërkesën e datës 01/04/2008, ka kërkuar nga e paditura që të gjitha aksionet të cilat kanë qenë në emër të “[M...]” me seli në Prishtinë, të regjistrohen në emër të “[A.G]”, përveç në Bankë edhe në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 29 dhe 30 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.1. e lidhur me nenin 199 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesat e paditëses është e bazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipër theksuara, për shkak se në procedurën e rigjykimit nuk i ka kryer të gjitha veprimet procedurale dhe nuk i ka shqyrtuar të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj, Ae.nr.32/2016 e datës 27/09/2017. Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që të zbaton sugjerimet e Gjykatës së Apelit e Kosovës të dhënë me aktvendimin Ae.nr.32/2016 e datës 27/09/2017 si dhe të kërkohet nga ARBK-ja që ti siguroj dokumentacioni mbi bazën e të cilës është bartur pronësia e aksioneve nga N.T.SH “[M...]” tek “[A.G]” dhe mandej ti vlerësoj të gjitha faktet tjera me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve dhe pastaj të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.98/18, me datën 13/07/2020

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v